



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e Grupit Punues për hartimin e Projekt-buxhetit të Komunës së Rahovecit për vitin 2023-2025

1. **Caktohet Grupi Punues për hartimin e Projekt-buxhetit të Komunës së Rahovecit për vitin 2023-2025, në këtë përbërje:**
 - 1.1 Ekrem Bytyqi – Drejtorja për Buxhet dhe Financa, kryesues
 - 1.2 Qëndresa Kryeziu – Drejtorja për Buxhet dhe Financa, anëtare
 - 1.3 Ardian Rama – Drejtorja për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, anëtar
 - 1.4 Antigona Krasniqi – Drejtorja për Arsim, anëtare
 - 1.5 Blerta Gashi – Zyrtare për Informim, anëtare
 - 1.6 Muharem Morina – Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar
 - 1.7 Albulena Rexha – Zyra e Kryetarit të Komunës, anëtare

Grupi punues ka për detyrë që të hartojë Projekt-buxhetin e Komunës së Rahovecit për vitin 2023-2025, të bëjë hartimin e Planit të Brendshëm komunal për mbarrëvajtjen e dëgjimeve buxhetore, të bëjë përgatitjen e njoftimit për mbajtjen e dëgjimeve buxhetore, të caktoj personin përgjegjës për mbajtjen e procesverbalit gjatë mbajtjes së dëgjimeve publike dhe të bëjë hartimin e tij në afatin ligjor që parashihet në Udhëzimin Administrativ për Standardet Minimale të Konsultimeve Publike, të bëjë hartimin e raportit nga dëgjimi buxhetor dhe ta përgatit për ta dërguar në Kuvendin Komunal.

2. Obligohet Grupi Punues që të veprojë duke u bazuar në ligjet dhe aktet nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës.
3. Grupi Punues do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në një afat të arsyeshëm.
4. Obligohet Grupi punues që pas përfundimit të punëve të hartoj raport me shkrim për Kryetarin e Komunës dhe Drejtorinë për Buxhet dhe Financa.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e grupit punues për hartimin e Projekt-buxhetit të Komunës së Rahovecit për vitin 2023-2025.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të Grupit Punues,
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivit.

	REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC	
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PREDSIEDNIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR'S CABINET		
Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)		
Nr./Br./No 2510 Nr. i faq./Br.str./No.pg 22		
Data/Datum/Date 28 / 7 / 22		
RAHOVEC / ORAHOVAC		

Smail Latifi

Kryetari i Komunës